



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



TIRANA PARKING

Tiranë, më 07.05.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHËRBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Mirëmbajtje rrjeti elektrik, aspirim, ventilim”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Instalime ventilimi ose kondicionerësh - 45331200-8; Shërbime elektrike - 71314100-3

Vlera e fondit limit: 5,286,866.66 (pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Tirana Parking, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga

autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit**, lëshuar nga autoriteti përkatës. *(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor).*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: ”40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit.....” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të **3 (tre) viteve të fundit** financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë

raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *(Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga **Pushteti Vendor për vitin 2025**, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare, si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si, referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat **ISO 9001:2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat **ISO 14001:2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat **ISO 45001:2018** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat **ISO 50001:2018** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojnë këto certifikata në përputhje me zërat që ka marrë përsipër të kryejë.

Shënim: Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 41 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit Kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar shërbim që plotëson kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj AK-së.

ISO 14001 (ose e përditësuar) specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqëndrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë, për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim:

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimit të aspekteve mjedisore;

- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

ISO 45001 (ose e përditësuar) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot, si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

ISO 50001 (ose e përditësuar) është një standard i ri ndërkombëtar i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar, të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë për mallrat e vendosura në përdorim, e cila do të jetë 1 (një) vit nga data e nënshkrimit të kontratës.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe pikës 6, të nenit 41 të VKM-së Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku specifikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Në këtë kuadër, kërkesa për garanci 1-vjeçare është vendosur për të garantuar cilësinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e mallrave dhe pajisjeve që do të përdoren në kuadër të shërbimit, duke siguruar që operatori ekonomik të mbajë përgjegjësi për çdo defekt apo problematikë që mund të konstatohet pas vendosjes në përdorim. Kjo kërkesë është në përputhje me parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike, si dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë. Gjithashtu, kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe synon të sigurojë realizimin me standarde të larta të kontratës, në përputhje me parimet e mirëadministrimit të fondeve publike dhe interesit publik.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm që duhet të jetë i përbërë nga:

- a. Minimalisht 7 punonjës të regjistruar gjatë 3 muajve të fundit;

- b. Minimalisht 1 person i Çertifikuar për sisteme Audio;
- c. Minimalisht 1 person i Çertifikuar për Sistemet kundër Zjarrit;
- d. Minimalisht 1 person i Çertifikuar dhe për sistemet e ndriçimit të daljeve të emergjencës;
- e. Minimalisht 3 persona të çertifikuar për instalimin e sistemeve të ndriçimit;
- f. Minimalisht 1 inxhinier elektronik/elektrik.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4) b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4) b).

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose..”

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Kërkesa për minimalisht 7 punonjës të regjistruar gjatë 3 muajve të fundit është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimeve që lidhen me mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, sistemeve të ventilimit dhe aspirimit. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin ndërhyrje të vazhdueshme teknike dhe mund të kërkojë reagim të menjëhershëm në raste defektesh apo emergjencash, autoriteti kontraktor vlerëson të domosdoshme që operatori ekonomik të ketë staf të mjaftueshëm aktiv dhe të disponueshëm për përmbushjen e kontratës.

Kërkesa për minimalisht 1 person të çertifikuar për sisteme audio është vendosur pasi objekti i mirëmbajtjes përfshin edhe sisteme teknike ndihmëse që lidhen me transmetimin audio dhe funksionalitetin e ambienteve institucionale. Çertifikimi i këtij personeli garanton që ndërhyrjet dhe mirëmbajtja do të realizohen nga specialistë me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme teknike, duke shmangur problematika që mund të ndikojnë në funksionimin normal të sistemeve.

Kërkesa për minimalisht 1 person të çertifikuar për sistemet kundër zjarrit është vendosur për shkak të rëndësisë që kanë këto sisteme në garantimin e sigurisë së ambienteve dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës. Sistemet kundër zjarrit janë sisteme sigurie me specifika teknike të veçanta dhe kërkojnë personel të kualifikuar për mirëmbajtjen, kontrollin dhe ndërhyrjet teknike. Kjo kërkesë synon të sigurojë që çdo ndërhyrje të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë.

Kërkesa për minimalisht 1 person të çertifikuar për sistemet e ndriçimit të daljeve të emergjencës është vendosur duke marrë në konsideratë rëndësinë funksionale dhe të sigurisë që kanë këto sisteme në rast emergjencash. Mirëmbajtja dhe kontrolli i tyre kërkon njohuri specifike teknike për të garantuar funksionimin korrekt dhe respektimin e standardeve të sigurisë në ambiente publike dhe institucionale.

Kërkesa për minimalisht 3 persona të çertifikuar për instalimin e sistemeve të ndriçimit është vendosur për të garantuar realizimin e ndërhyrjeve dhe mirëmbajtjes së sistemeve elektrike dhe të ndriçimit në mënyrë profesionale dhe në kohë. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin volume pune dhe ndërhyrje të ndryshme në sistemet e ndriçimit, autoriteti kontraktor e vlerëson të nevojshme disponimin e një numri të mjaftueshëm specialistësh të kualifikuar për përmbushjen e kontratës sipas standardeve teknike.

Kërkesa për minimalisht 1 inxhinier elektronik/elektrik është vendosur për të garantuar drejtimin teknik, mbikëqyrjen profesionale dhe diagnostikimin e problematikave që lidhen me rrjetin elektrik dhe sistemet teknologjike objekt mirëmbajtjeje. Prania e një inxhinieri të profilit përkatës është e domosdoshme për të siguruar që ndërhyrjet teknike të realizohen në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat teknike të kontratës, duke garantuar sigurinë dhe funksionalitetin e sistemeve.

2.3.5 Të disponojë në pronësi ose me qira:

- 2 (dy) copë mjete ngritëse me rrota për përdorim në ambjente të mbyllura (Platformë), të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë ose kontrata noteriale e qirasë.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe**

pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa më sipër cituar lind e nevojshme edhe disponimi i makinerive të kërkuara me numrin dhe llojin e përcaktuar është vendosur duke ju referuar zërave të shërbimit sipas specifikimeve teknike dhe kohëzgjatjes së shërbimit. Duke qenë se ndërhyrjet teknike për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, ndriçimit, ventilimit dhe aspirimit realizohen shpesh në lartësi dhe në ambiente të brendshme, përdorimi i mjeteve ngritëse të përshtatshme është i domosdoshëm për garantimin e kushteve të sigurisë teknike dhe realizimin korrekt të punimeve. Disponimi i 2 (dy) platformave synon të sigurojë kapacitet të mjaftueshëm operacional për kryerjen simultane të ndërhyrjeve në ambiente apo sisteme të ndryshme, si dhe për përballimin e situatave emergjente apo defekteve që kërkojnë reagim të menjëhershëm. Kërkesa që këto mjete të provohen nëpërmjet dokumentacionit të pronësisë ose kontratës noteriale të qirasë vendoset për të garantuar disponueshmërinë reale të tyre gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës dhe për të shmangur deklaratimet formale pa mbështetje konkrete.

2.3.6 Produktet duhet të jenë të pajisura me çertifikatë konformiteti (CE) ose ekuivalente, në përputhje me standardet e miratuara ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 41 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kërkesa që produktet të jenë të pajisura me certifikatë konformiteti (CE) ose ekuivalente është vendosur në funksion të garantimit të cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë teknike të mallrave që do të përdoren në kuadër të objektit të prokurimit. Duke qenë se pajisjet dhe materialet që lidhen me sistemet elektrike, ventilimin, aspirimin dhe sistemet ndihmëse kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë teknike të ambienteve dhe funksionimin normal të tyre, autoriteti kontraktor vlerëson të domosdoshme që këto produkte të jenë të çertifikuara sipas standardeve të njohura ndërkombëtare. Certifikata CE ose ekuivalente provon se produktet përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë, mbrojtjes së shëndetit, performancës dhe mbrojtjes së mjedisit, sipas standardeve europiane dhe ndërkombëtare në fuqi. Gjithashtu, kjo kërkesë është në përputhje me legjislacionin për vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut, i cili synon që produktet e vendosura në përdorim të përmbushin standardet e sigurisë dhe performancës. Përcaktimi “CE ose ekuivalente” është bërë për të respektuar parimin e mosdiskriminimit dhe të konkurrencës së lirë, duke lejuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që ofrojnë produkte të certifikuara sipas standardeve të barasvlershme ndërkombëtare.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike dhe kriteret teknike të veçanta të kualifikimit janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt **“Mirëmbajtje rrjeti elektrik, aspirim, ventilim”**, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”**.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **“Mirëmbajtje**

rrjeti elektrik, aspirim, ventilim”, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Në Specifikimet Teknike, në rastet kur është përshkruar markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për objektin e prokurimit, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e shërbimit.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtarë të njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Mirëmbajtje rrjeti elektrik, aspirim, ventilim”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.